

VENDIM
Nr. 99, datë 12.2.2025

**PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT DHE
DETYRAT E KOMITETIT PËR TË DHËNAT STATISTIKORE NË TURIZËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti për të Dhënat Statistikore në Turizëm, këtu e në vijim “Komiteti”, është organi koordinues pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i cili mundëson bashkëpunimin ndërinstitucional për koordinimin dhe integrimin efektiv të të dhënave statistikore, të lidhura me turizmin në nivel qendror dhe vendor.

2. Komiteti kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe ka në përbërje përfaqësues në nivel të lartë drejtues nga institucionet e mëposhtme:

- a) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- b) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- c) Ministria e Brendshme;
- ç) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- d) Banka e Shqipërisë;
- dh) Instituti i Statistikave;
- e) bashkitë Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër dhe Elbasan;
- ë) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- f) Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- g) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- gj) Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit;
- h) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

3. Në varësi të çështjeve dhe kur e çmon të nevojshme, Komiteti fton të marrin pjesë në mbledhjet e tij përfaqësues edhe nga njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore, përveç sa janë përmendur në shkronjën “ë”, të pikës 2, të këtij vendimi, si dhe grupet e interesit në fushën e turizmit.

4. Komiteti mbledhet si rregull të paktën 2 (dy) herë në vit. Mbledhja thirret nga kryetari kryesisht ose me kërkesë të një prej anëtarëve.

5. Kryetari, në rastet urgjente apo kur e vlerëson të nevojshme, thërret mbledhjen e Komitetit. Në këtë rast, rendi i ditës i propozuar dhe materialet për diskutim u vihen në dispozicion anëtarëve në fillim të mbledhjes.

6. Njoftimi për mbledhjen e Komitetit dhe çështjet për diskutim, pjesë e rendit të ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues i përcillen çdo anëtarë në rrugë elektronike nga sekretariati teknik, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi përfshin informacionin për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes.

7. Mbledhjet drejtohen nga kryetari dhe në rast se ai mungon apo është në pamundësi për të ushtruar funksionin e tij, mbledhja e thirrur drejtohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për turizmin.

8. Konkluzionet për çështjet e diskutuara sipas rendit të ditës pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse të Komitetit, të mbajtur nga sekretariati teknik.

9. Komiteti kryen këto detyra:

a) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, pjesë e komitetit, të cilat merren me procesin e mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave në fushën e turizmit në Republikën e Shqipërisë;

b) bashkëpunon me INSTAT-in dhe Bankën e Shqipërisë për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave të turizmit, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, duke respektuar parimin e pavarësisë profesionale;

c) koordinon punën me institucionet përgjegjëse për përcaktimin e standardeve funksionale dhe operacionale të të dhënave të databazës së të dhënave shtetërore, të ngritura sipas parashikimit të nenit 66, të ligjit nr. 93/2015, të ndryshuar, si dhe për harmonizimin e karakteristikave teknike të Sistemit të Informacionit të Turizmit, në të cilin integrohen të dhënat e Regjistrit Qendror të Turizmit dhe të Sistemit të të Dhënave të Turizmit;

ç) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar krijimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen teknike të Sistemit të Informacionit të Turizmit;

d) bashkërendon procesin për monitorimin e zbatimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të të dhënave në turizëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

dh) bashkëpunon me INSTAT-in në drejtim të zhvillimit të llogarive satelitore të turizmit, në përputhje me programin e statistikave zyrtare dhe planin vjetor në zbatim të tij;

e) bashkëpunon me INSTAT-in për zbatimin e vrojtimeve mbi temën e turizmit, në përputhje me programin e statistikave zyrtare dhe planin vjetor në zbatim të tij;

ë) bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë në funksion të mbledhjes së të dhënave nga vrojtimet dhe përpunimin e të dhënave që kanë të bëjnë me sigurimin e të dhënave statistikore që lidhen me turizmin;

f) bashkëpunon me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në funksion të zbatimit të vrojtimeve që kanë të bëjnë me institucionet përgjegjëse për kulturën;

g) bashkëpunon me Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në funksion të formalizimit fiskal të subjekteve në sektorin e turizmit, duke verifikuar dhe harmonizuar të dhënat statistikore me ato fiskale;

gj) bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme, Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në funksion të mbledhjes së të dhënave statistikore sa më të plota dhe cilësore nga të gjitha pikat kufitare;

h) bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të mbledhjes së të dhënave statistikore nga aktiviteti i subjekteve përkatëse në funksion të zhvillimit të turizmit rural dhe agroturizmit;

i) bashkëpunon me të gjitha institucionet publike, ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe bashkitë, si dhe entitetet pritëse, bizneset dhe shoqatat e sektorit të turizmit, për të siguruar cilësinë e nevojshme për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në turizëm;

j) përcakton tipologjinë, formatin dhe periodicitetin e raporteve të bazuara në të dhënat statistikore në turizëm.

10. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e luan struktura përgjegjëse për statistikën në ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ka këto detyra:

a) administron të gjitha kërkesat drejtuar Komitetit;

b) njofton anëtarët për mbledhjet e Komitetit dhe vendos në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm;

c) mban procesverbalet e çdo mbledhjeje të Komitetit.

11. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të caktojnë përfaqësuesit e tyre si anëtar të Komitetit.

12. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Komiteti për të Dhënat Statistikore në Turizëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku